

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Arsimin, Kulturën dhe Sportin

RAPORT VENDIMMARRJE
Nr. 01 datë 03.09.2025

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit Planin për Arsimin Parauniversitar të Bashkisë Tropojë

Komisioni i Arsimit i Këshillit Bashkiak Tropojë, në mbledhjen e tij, shqyrtoi dhe analizoi Planin e Arsimit Parauniversitar të Bashkisë për periudhën afatmesme.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe konsultimeve publike me institucionet arsimore, dhe palet e interes, komisioni thekson rëndësinë e këtij plani për zhvillimin e sistemit arsimor lokal dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Baza Ligjore

Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 27.02.2019, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2019–2025”;

Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për hartimin dhe zbatimin e planeve vendore;
Strategjitë kombëtare për zhvillimin e arsimit dhe procesin e integritimit evropian.

Rëndësia e Planit

Plani i Arsimit Parauniversitar është një dokument strategjik që synon:

- Përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe kushteve të të nxënit;
- Rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përgatitjes së mësuesve;
- Sigurimin e aksesit të barabartë në arsim për të gjithë fëmijët;
- Mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Zvogëlimin e braktisjes shkollore dhe rritjen e përfshirjes së komunitetit;
- Përmirësimin e partneriteteve ndërmjet shkollës, familjes dhe komunitetit.

Rekomandimi :

Komisioni i Arsimit, pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe bazën ligjore, arrin në përfundimin se Plani i Arsimit Parauniversitar është një domosdoshmëri për zhvillimin afatgjatë të arsimit në Bashkinë Tropojë.